



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-17282

Datë: 15.10.2025

Prizren

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit, duke vendosur sipas kërkesës së “Tallku” sh.p.k., - investitor, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e projektit kryesor së bashku me Vendimin për Leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, përkatësisht pjesës së suterrenit dhe bodrumit, konform dispozitave të nenit 22, 26 paragrafi 1 dhe nenit 27 paragrafi 1, lidhur me nenet 44, 45, 46, 47, 48, lidhur me nenin 83, 87 si dhe nenin 88, 89 dhe 94 e konform dispozitave të nenit 125 dhe 127 të LPPA-së, bie këtë:

AKTVENDIM

- I. **Aprovohet** kërkesa e “Tallku” sh.p.k., - investitor, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e Projektit kryesor së bashku me Vendimin për Leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, përkatësisht pjesën e suterrenit dhe bodrumit, si e bazuar.
- II. **Ndryshohet** pjesërisht Projekti kryesor së bashku me vendimin për leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, dhe atë vetëm sa i përket pjesës së bodrumit dhe suterrenit, përkatësisht Blloku D nga 2B+P+8+Ph në 1B+P+8+Ph, Blloku E nga B+S+P+8+Ph në S+P+8+Ph, Blloku F nga B+S+P+6 në S+P+6, Blloku G nga B+S+P+8+Ph në S+P+8+Ph dhe Blloku H nga 2B+P+8+PH, në 1B+P+8+Ph, ndërsa ndërtimi nën sheshin e brendshëm Blloku I,J,K,L dhe M mbeten me nje etazh bodrum të cilat shtrihen në ngastrat kadastrale nr. P-71813068-08976-7, 08976-10; 08976-11, 08979-0, 08980-0, 08976-4, 08979-6 ZK Prizren, ndërsa pjesa tjetër e projektit kryesor dhe vendimit për leje ndërtimore mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim është pjesë përbëse e aktit administrativ Vendimit për Leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024 së bashku me projektin kryesor dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

Arsyetim

Parashtruesi i kërkesës “Tallku”, sh.p.k., pranë shërbimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë në Komunën e Prizrenit, ka paraqitur kërkesë me nr. 04-353/01-0017282, të datës 04.02.2025, me të cilën ka kërkuar ndryshimin e projektit kryesor së bashku me Vendimin për Leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, përkatësisht pjesës së suterrenit dhe bodrumit.

Në bazë të dokumentacionit të cilin e posedon DUPH, investitori “Tallku” sh.p.k., nga ana e DUPH-së është pajisur me vendimin për leje ndërtimore N. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, për ndërtimin e objektit multifunksional, banim kolektiv me lokale afariste në Prizren, në rr. “Tahir Sinani”, i cili shtrihet në kuadër të ngastrave kadastrale nr. P-71813068-08976-7, 08976-10; 08976-11, 08979-0, 08980-0, 08976-4, 08979-6 ZK Prizren, me etazhitet **Blloku A** (B+P+9+Ph); **Blloku B** (B+P+9+Ph); **Blloku C** (B+P+9+Ph); **Blloku D** (2B+P+8+Ph); **Blloku E** (B+S+P+8+Ph); **Blloku F** (B+S+P+6); **Blloku G** (B+S+P+8+Ph) dhe **Blloku H** (2B+P+8+Ph) me sipërfaqe S=17,707.75 m².

Me rastin e paraqitjes së kërkesës nga ana e investitorit “Tallku” sh.p.k., për ndryshimin e projektit kryesor së bashku me Vendimin për Leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, përkatësisht pjesës së

suterrenit dhe bodrumit, i njëjti kërkesës i ka bashkangjitur Raportin Gjeoteknik, të datës 09 Gusht 2024, të punuar nga kompania N.Sh. "Test&Ing", me seli në rr. "Hajdin Berisha", në Suharekë, me drejtor ekzekutiv Ing. Gjeol. Shefki Bytyqi, po ashtu punuar nga ai dhe Ing. Ndërt. Egest Veselaj.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit, pas pranimit të kërkesës së lartcekur, konsultimit të shkresave të lëndës, konkretisht Vendimit për Leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, si dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative konstatoi se kërkesa është e bazuar.

DUPH vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimide e miratuar kërkesën si të bazuar, ndërsa si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që bazuar në Raportin Gjeoteknik, të datës 09 Gusht 2024, të punuar nga kompania N.Sh. "Test&Ing", me seli në rr. "Hajdin Berisha", në Suharekë, me drejtor ekzekutiv Ing. Gjeol. Shefki Bytyqi, po ashtu punuar nga ai dhe nga Ing. Ndërt. Egest Veselaj, përkatësisht tek kapitulli 5 - Kushtet gjeo-inxhinierike, pika 5.5. Kushtet hidrologjike, faqe 63, ku ceket se "Gjatë punimeve hulumtuese më datë 27.06.2024 është paraqitur niveli i ujit nëntokësor në të dy shpimet sondazhe. Niveli i ujit nëntokësor në shpimin e parë sondazhë është paraqitur në thellësi 4.8 m nën nivelin e sipërfaqes së tokës (367.3 m lartësi) kurse në shpimin e dytë në thellësi 4.1 m (367.3 m lartësi) dhe se në bazë të kësaj, investitori pas fillimi të punimeve në terren ka hasur në ujëra të shumta nëntokësor (vis major) të cilat ujëra ndikojnë direkt në sigurinë e objektit dhe hapësirave për rreth tij. Raportit i ka bashkangjitur skicën e matjeve gjeodezike nga gjeodeti i licensuar Sadri Elshani me nr.licenses 324 dt.24.09.2025 dhe fotot nga vendpunishtja .

Andaj, bazuar në të lartcekurat, Projekti kryesor së bashku me vendimin për leje ndërtimore Nr. 04-351/02-125035, të datës 02.10.2024, ndryshohet dhe atë vetëm sa i përket pjesës së bodrumit dhe suterrenit, përkatësisht përkatësisht Blloku D nga 2B+P+8+Ph në 1B+P+8+Ph, Blloku E nga B+S+P+8+Ph në S+P+8+Ph, Blloku F nga B+S+P+6 në S+P+6, Blloku G nga B+S+P+8+Ph në S+P+8+Ph dhe Blloku H nga 2B+P+8+PH, në 1B+P+8+Ph ndërsa ndërtimi nën sheshin e brendshëm Blloku I,J,K,L dhe M mbeten me nje etazh bodrum të cilat shtrihen në ngastrat kadastrale nr. P-71813068-08976-7, 08976-10; 08976-11, 08979-0, 08980-0, 08976-4, 08979-6 ZK Prizren, ndërsa pjesa tjetër e projektit kryesor dhe vendimit për leje ndërtimore ka mbetur e pa ndryshuar.

Nga ana e investitorit "Tallku" sh.p.k., mbetet të punohet projekti kryesor sipas ndryshimeve të bëra në këtë aktvendim dhe i njëjti të sillet në këtë drejtori për nënshkrim dhe vulosje.


Andaj, DUPH në bazë të provave të cilat i posedon dhe me rastin e vlerësimit të tyre ka gjetur se kërkesa është e bazuar dhe se vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi.


I njëjti ndryshim vlen edhe tek Njoftimi për plotësim të dokumentacionit (Kushtet Ndërtimore), Nr. 04-353/01-46357, të datës 22.05.2024.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj drejtorie.

Bashkëpunëtoreshë profesionale


Egzona Morina Thaqi, inxh.dip.ark.



Drejtori


Pranverim Berisha, jur.i.dipl.